



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 49
Prishtinë, më 21.06.2010 në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N- 225

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Arsim Rexhepi, kryetar, Drita Kadriu, Enis Kervan, Donika Kadaj –Bujupi, Heset Cakolli, Adem Hajdaraj, Ismail Kurteshi dhe Dragan Dimiq.

Mungoi: Mark Krasniqi.

Në mbledhje prezantuan: përfaqësuesi i OSBE - së, NDI - së, përfaqësues nga mediat, përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit si dhe praktikantë të caktuar për Komisionin.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë Lule Ymeri, Drita Çarkaxhiu dhe Shaip Goxhuli

Mbledhjen e udhëhoqi: Arsim Rexhepi kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 18.05.2010,
3. Shqyrtimi i Programit Kombëtar të Shkencës,
4. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

1. Miratimi i rendit të ditës

Adem Hajdaraj, propozoi se Komisioni duhet të shqyrtojë kërkesën e Dekanatit të Fakultetit të Edukimit lidhur me kohëzgjatjen e moshës së pensionimit të mësimitdhënësve universitarë. Kjo çështje nuk është e përfshirë në Ligjin për Shërbyesit Civil, andaj mendon se Qeveria duhet të nxjerrje një akt plotësues që të rregullohet kjo çështje. Ceku se kjo çështje duhet diskutuar si pikë e veçantë në një mbledhje të radhës

Drita Kadriu, theksoi që në pikën nën të ndryshme të diskutohet çështja e vizitave në Shqipëri dhe në Turqi. Njëkohësisht pajtohet me propozimin e Adem Hajdaraj, lidhur me çështjen e pensionimit të mësimitdhënësve sepse me Ligjin e Shërbyesve Civil nuk është përfshirë kohëzgjatja e moshës së pensionimit të mësimitdhënësve universitarë.

Heset Cakolli, kërkoj që të shqyrtohet raporti nga vizita në Shqipëri dhe asaj në Turqi dhe propozoi që kjo temë të caktohet si pikë e veçantë në mbledhje të radhës.

Më këto propozim u pajtuan anëtarët e Komisionit, dhe u miratua rendi i ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 18 .05.2010.

Kryesuesi konstatoi se procesverbali i mbledhjes së 18.05.2010 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Programit Kombëtar të Shkencës

Kryesuesi, theksoi se është kërkesë e Kryesisë, që Komisionet ta shqyrtojnë Programin Kombëtar të Shkencës dhe më pas ta procedojmë për miratim në Kuvend . Lidhur me këtë pikë fjalën diskutoi Drita Kadriu.

Drita Kadriu, tha se Këshilli Kombëtar i Shkencës është organ i cili është themeluar nga Kuvendi. Këshilli, për një vit e gjysmë nuk ka zhvilluar ndonjë aktivitet për arsye të rrethanave objektive. Në vitin e kaluar, KKSH ka filluar hartimin e programit Kombëtar të Shkencës.

Ky program është prezantuar në Konferencën e quajtur Java e Shkencës, ku jemi informuar për mënyrën e hartimit të dokumenteve, për kushtet e infrastrukturës kërkimore shkencore dhe rreth kritereve të prioriteteve .

Ajo tha se Programi Kombëtar i Shkencës i plotëson të gjitha standardet, dhe për këtë falënderoi angazhimin korrekt të sekretariatit teknik. Në këtë program janë integruara këto prioritete; burimet natyrore energjia dhe mjedisi, prodhimi bujqësorë dhe siguria e ushqimit, kërkimet shkencore në mjekësi, studimet shoqërore dhe ekonomike, studimet shkencore, kulturore dhe historike dhe në fund studimet shkencore ndër-horizontale të teknologjisë së informimit dhe komunikimit.

Ajo përkrah programin Kombëtar të Shkencës dhe shprehë falënderim për gatishmërinë e Qeverisë e cila ka nda një milion euro dhe se në mënyrë progresive në vitin 2015 do të arrijë në gjashtë milion. Sugjeroi që të krijohen kushte objektive për funksionalizimin e këtij Këshilli, të sigurohet një zyre dhe një administrator.

Heset Cakolli, Ai përjrah programin Kombëtar të Shkencës për periudhën afatmesme deri 2015.

Fillimisht, ky organ nga 16 prioritetet kombëtare shkencore ka rezultuar me pesë prioritete. Ai diskutoi për burimet natyrore, energjinë dhe mjedisin dhe theksoi se pa mbështetje të kësaj fushe nuk do të ketë zhvillim ekonomik të vendit. Gjithashtu mbështet vendimin e Qeverisë për ndarje buxhetore për këtë Këshill.

Ai plotësisht mbështet programin Kombëtar të Shkencës dhe se komisioni duhet të procedojë miratimin e tij në Kuvend.

Adem Hajdaraj, theksoi se drafti i programit Kombëtarë të Shkencës është punuar në mënyrë profesionale nga anëtarët e grupit punues të Këshillit Kombëtar të Shkencës, i cili program ofron ngritje zhvillimore shkencore në Kosovë.

Ai plotësisht përkrah program Kombëtar të Shkencës, njëkohësisht përkrah edhe vendimin e Qeverisë për financimin e këtij programi, andaj theksoi se i njëjti duhet të procedohet në Kuvend.

Ismail Kurteshi, pajtohet me parafolësit dhe theksoi se plotësisht mbështet programin Kombëtar të Shkencës.

Kryesuesi, konstatoi se sipas kërkesës së KSSH të sigurohet një hapsir pune dhe staf administrativ që është më se i domosdoshëm për funksionalizimin e tij.

Anëtarët e komisionit për Arsim, Shkencë, Tekologji, Kulturë, Rini dhe Sport e përkrahën këtë kërkesë të KSSH.

Komisioni për Arsim, Shkencë, Tekologji, Kulturë, Rini dhe Sport pas shqyrtimit të programit Kombëtarë të Shkencës, nxori këtë:

Rekomandim

Komisioni i rekomandon Kuvendit të miratojë Programin Kombëtarë të Shkencës të Republikës së Kosovës për periudhën pesë vjeçare.

4. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritime Evropiane

Kryesuesi, tha se lidhur me këtë pikë, me datën 9.06.2010 është caktuar mbledhja e përbashkët me Komisionin për Integritime Evropiane. Ai ceku se për arsye të angazhimeve të tija nuk mund të marr pjesë në këtë takim. Lidhur me këtë pikë fjalën ia dha Drita Kadriu.

Drita Kadriu, tha se për zbatimin e Planit të Veprimit është qasja e delegimit të detyrave në komisione, andaj si detyrë kryesore është hartimi i një dokumenti i cili duhet ti dorëzohet Komisionit për Integritime Evropiane. Aktivitetet e Komisionit tanë janë paraparë, shqyrtimi dhe përmbushja e detyrave që ndërliiden me çështjet e fushës së arsimit, çështja e fëmijëve me nevoja të veçanta, përfshirja e tyre në arsim, qasja e tyre në objekte shkollore.

Në takimin e përbashkët me Komisionin për Integritime Evropiane ka qenë i ftuar Ministri i Arsimit, i cili ka raportuar lidhur me të gjitha çështjet që ne i kemi ngrit në takimin paraprake me ministrin e Arsimit. Ajo theksoi se është mirë që të ftohet Ministri për Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me çështjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe Ministri i Punëve të Brendshme lidhur me çështjen e shkallës së trafikimit të fëmijëve, dhe në bazë të këtij takimi veçmas do të nxjerrim Rekomandime të cilin do ti procedojmë në Komisionin për Integritime Evropiane dhe në Kuvend.

Heset Cakolli- tha se takimi me Komisionin për Integritime Evropiane ka qenë i dobishëm ku është diskutuar për katër sfidat që paraqiten në raportin e progresit në fushat që i mbulon Ministria e Arsimit. Ceku se në takimin paraprak të komisionit tanë, është kërkuar nga ministri i Arsimit raporti me shkrim për përmbushjen e këtyre sfidave.

Kryesuesi, theksoi se detyrimet që dalin nga sfidat e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritime Evropiane, Komisioni ka ftuar Ministrin e Kulturës, Rinës dhe Sportit për shqyrtim

strategjinë e konservimit të trashëgimisë kulturore dhe religjioze dhe si detyrim tjetër është organizimi i dëgjimit publik me Ministrinë e Arsimit, Teknologjisë rreth çështjes së librave shkollore në gjuhën e komuniteteve.

Komisioni konstatoi se me datë 24.06.2010 të ftojë Ministrin e Punëve të Brendshme që të raportojë lidhur me çështjen e trafikimit të fëmijëve. Në bazë të rrjedhave që dalin nga ky takim Komisioni do të nxjerr Rekomandime, të cilat do ti procedojë në Komisionin për Integritet Evropian dhe në Kuvend.

5. Të ndryshme

Kryesuesi, informoi komisionin për rrjedhat e kërkesës së shoqatës së arkeologëve të Kosovës dhe për gjendjen e Trashëgimisë Kulturore në Kosovë.

Ai tha se në javën e parë të muajit korrik të organizojmë dëgjim Publik, ku do të ftojme Ministrinë e Kulturës, përfaqësues të Këshillit të Trashëgimisë Kulturore, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të grupeve të interesit.

Kryesuesi, konstatoi se komisioni me datën 7.07.2010, do të mbajë Dëgjim Publik lidhur çështjen e Trashëgimisë Kulturore në Kosovë.

Heset Cakolli, kërkoi që Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport që të dërgoi një shkresë falënderuese për pritjen e jashtëzakonshme nga vizita në Turqi.

Kryesuesi, i njoftoi anëtarët e Komisionit se ka përgatit një shkresë falënderuese për pritjen e organizuar nga Parlamenti i Madh i Republikës së Turqisë, për përkrahje të Komisionit në çështjet e Universitetit të Prizrenit me staf akademik, angazhimi i tyre në marrjen e shumë studentëve në master e në doktoratë dhe përkrahjen e organizimit të Konferencës ndërkombëtare të Arsimit, e cila parashihet të mbahet gjatë muajit tetor në Prishtinë. Ai tha se këtë dokument do ta paraqes në mbledhje të radhës.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 12: 20

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Arsim Rexhepi